



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



**Procesverbali i Mbledhjes**

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore  
Mbledhja e datës 14 maj 2026**

## Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 459, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave ”Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre”.....	2
2. Projektvendimi ”Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 479, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave “Per krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”.....	3
3. Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta-akti i infrastrukturës Gigabit”.....	4
4. Projekturdhëri e Kryeministrit “Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale për sezonin turistik 2026”.....	5
5. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”.....	6
6. Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoriatit të përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e te dhënave të sistemit elektronik ”e-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumentave të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”.....	9
7. Projektudhëzimi “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave dhe vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg, për vitin 2025, në përputhje me shkronjën ”dh”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018 ”Për strehimin social”, i ndryshuar.....	9
8. Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës, mënyrës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe të formatit tip të kontratës”.....	10
9. Projektvendimi “Për miratimin e rregullores tip “Për administrimin e banesave dhe ndërtesave”.....	10
Shtojcë:	
Të pranishëm .....	11

## Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 14 maj 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua online, në platformën Teams, ku morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve dhe pa humbur kohë ja kaloi fjalë përfaqësueseve nga Fondi Shqipëtar i Zhvillimit për prezantimin e akteve të propozuara nga Zëvendëskryeministri.

## PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

**1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 459, datë 30.7.2021, të Këshillit të Ministrave ”Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre”,** propozuar nga Zëvendëskryeministri u prezantua nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv, Fondi Shqipëtar i Zhvillimit dhe Z. Fatjon Nanaj, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit

Z. Nanaj në fjalën e tij theksoi se ky dokument prezanton riorganizimin e rajoneve zhvillimore në Shqipëri, duke synuar një ndarje më funksionale sesa thjesht gjeografike.

Arsyeja e ndryshimeve është reflektimi i Censurit 2023 dhe nevoja për t’iu përgjigjur rritjes së popullsisë në zonën metropolitane të Tiranës dhe tkurrjes në zonat malore e periferike, dinamikat e reja ekonomike dhe përshtatja me rritjen e sektorëve të ndërtimit, shërbimeve dhe turizmit, tranzicioni drejt Rajoneve Funksionale, si dhe kalimi nga kufijtë e thjeshtë administrativë drejt rajoneve që bazohen në lidhjet reale ekonomike, sociale dhe infrastrukturore.

Ndryshimet konkrete sipas aktit, në hartë janë;

- Rajoni 2 rikonfigurohet duke përfshirë qarqet Dibër, Tiranë, Durrës dhe Elbasan;
- Zona Metropol brenda Rajonit 2, identifikohet një zonë me karakter të veçantë që përfshin bashkitë Tiranë dhe Kamëz, për shkak të peshës së tyre të lartë ekonomike dhe demografike;
- Lëvizjet e Qarqeve, ku Elbasani kalon në Rajonin 2, ndërsa Gjirokastra riorientohet drejt Rajonit 3.

Gjithashtu Z. Nanaj theksoi parimet dhe synimet e aktit si;

- Specializimi Inteligent, ku çdo rajon duhet të zhvillohet bazuar në potencialet dhe avantazhet e veta unike;
- Përafrimi me BE-në ku synohet përdorimi më efikas i financimeve të Bashkimit Europian dhe ndjekja e qasjes së tyre për kohezionin rajonal;
- Investime të Targetuara si; lehtësimi i investimeve specifike për zona urbane, rurale apo periferike sipas nevojave të tyre reale.

Z. Agolli në ndërhyrjen e tij përmendi përfitimet e pritshme për të dy aktet në zhvillimin e rajoneve si;

- Planifikim rajonal më i saktë dhe funksional;
- Zhvillim territorial që bazohet në identitetin dhe burimet unike të çdo zone;
- Sinergji më e mirë ndërmjet rajoneve dhe koordinim i shtuar i politikave zhvillimore.

Komente nuk ka.

**2. Projektvendimi ”Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 479, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave “Per krijimin, përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK)”, propozuar nga Zëvendëskryeministri u prezantua nga u prezantua nga Z. Dritan Agolli, Drejtor Ekzekutiv, Fondi Shqipëtar i Zhvillimit dhe Z. Fatjon Nanaj, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit**

Z Nanaj në fjalën e tij theksoi se projektvendimi fokusohet në riorganizimin institucional të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK), duke synuar një strukturë më të qëndrueshme dhe efikase.

Në akt theksohet qëllimi i ndryshimeve institucionale si;

- Rritja e eficiencës dhe sigurimi i një strukture që funksionon më shpejt dhe me më shumë koherencë në vendimmarrje;
- Stabiliteti afatgjatë dhe shmangia e ndikimit nga ndryshimet e shpeshta ministrore apo riorganizimet e portofoleve qeveritare;
- Harmonizimi i strukturave dhe unifikimi i përfaqësimit qendror dhe vendor në mekanizmat që menaxhojnë politikën dhe fondet e zhvillimit rajonal.

Gjithashtu, z. Nanaj u ndal në unifikimin FSHZH (Fondin Shqiptar të Zhvillimit)

- Përbërja e KKZHRK-së bëhet e njëjtë me atë të Këshillit Drejtues të FSHZH-së;
- Megjithëse anëtarët janë të njëjtë, KKZHRK dhe FSHZH mbeten dy organe të ndara ligjërisht, që veprojnë mbi baza të ndryshme ligjore;
- Sekretariati Teknik i FSHZH do të shërbejë si sekretariat teknik dhe strukturë mbështetëse për KKZHRK-në, duke ofruar asistencë organizative dhe monitoruese.

Përbërja e re e komitetit është me (11 Anëtarë), ndërsa struktura e re e KKZHRK-së përbëhet nga:

- Kryetari, Zv. Kryeministri;
- Pushteti Qendror me 4 anëtarë (ministra ose zv. ministra).;
- Pushteti Vendor me 6 anëtarë, duke rritur kështu përfaqësimin e aktorëve lokalë.

Z. Agolli përmendi përfitimet kryesore siç janë;

- Thjeshtimi administrativ ku shmangen fragmentimet dhe mospërputhjet mes dy organeve kryesore të zhvillimit rajonal;
- Koordinim strategjik i cili krijon një strukturë më e aftë për të menaxhuar në mënyrë të konsoliduar politikat ndërsektoriale dhe instrumentet e financimit;
- Bashkëpunim i zgjeruar ku mundësohet përfshirje më e mirë e donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë në proceset e zhvillimit.

Komente nuk ka.

**3. Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta-akti i infrastrukturës Gigabit** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë u prezantua nga *Znj. Irena Malolli, Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

Znj. Malolli theksoi se projektligji për aktin e infrastrukturës Gigabit (GIA), synon të rregullojë dhe të lehtësojë shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi shumë të lartë në Shqipëri.

Gjithashtu, përmendi qëllimin e aktit si;

- Përafrimi me BE-në ku projektligji synon përafrimin e plotë me Rregulloren (BE) 2024/1143 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit;
- Shpejtësia e lartë me objektiv nxitjaen e shtrirjes së rrjeteve me shpejtësi gigabit për të mbështetur transformimin digjital;
- Ulja të kostove dhe lehtësimi i bashkërendimit të punëve civile dhe përdorimi i infrastrukturës fizike ekzistuese për të ulur kostot e shtrirjes së rrjetit.

Znj Malolli u ndal në shtyllat kryesore të projektligjit si;

- Aksesin në infrastrukturën fizike ku operatorët kanë të drejtë të aksesojnë infrastrukturën fizike ekzistuese të operatorëve të tjerë të rrjetit (energji, ujë, transport) për shtrirjen e elementeve të rrjeteve VHCN (Very High Capacity Networks);
- Transparenca dhe krijimi i një pike të vetme informacioni për të siguruar të dhëna mbi infrastrukturën fizike ekzistuese dhe punët civile të planifikuara;
- Bashkërendimi i punëve civile dhe mundësimi i bashkëpunimit mes operatorëve gjatë gërmimeve apo ndërtimeve për të shmangur dyfishimin e kostove dhe pengesat në trafik.

Gjithashtu, infrastruktura brenda ndërtesave ndahet në;

- Ndërtimet e reja ku të gjitha ndërtesat e reja dhe ato që i nënshtrohen rinovimit të madh duhet të pajisen me infrastrukturë fizike të brendshme të gatshme për gigabit;
- Pika e aksesit ku çdo ndërtesë duhet të ketë një pikë aksesit ku ofruesit e rrjetit mund të lidhen lehtësisht;
- E drejta e aksesit ku ofruesit e rrjeteve kanë të drejtë të aksesojnë infrastrukturën brenda ndërtesës me kushte të drejta dhe jo-diskriminuese.

Përsa i përket lejeve dhe digjitalizimit, znj Malolli theksoi se procedurat e aplikimit për leje ndërtimi për rrjetet e komunikimit do të kryhen përmes një pike të vetme kontakti në format digjital, dhe vendosja e afateve të qarta për dhënien ose refuzimin e lejeve për të shmangur vonesat burokratike.

Gjithashtu, autoritetet përgjegjëse janë;

- AKEP (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), i cili do të veprojë si organi përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe si pikë e vetme informacioni;
- Ministria përgjegjëse që do të mbikëqyrë zbatimin e politikave të përgjithshme të Aktit të Infrastrukturës Gigabit.

Komente nuk ka.

#### **4. Projekturdhëri i Kryeministrit “Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale për sezonin turistik 2026”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit u prezantua nga Z. Elton Orozi, Drejtor, Drejtoria e Standardeve të Turizmit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.**

Z. Orozi theksoi se ky dokument prezanton krijimin e Task-Forcës Ndërinstitucionale për Mirëmenaxhimin e Sezonit Turistik 2026, një strukturë e përkohshme me fokus koordinimin e masave për mbarëvajtjen e turizmit në Shqipëri me qëllim mirëmenaxhimin e sezonit dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për të garantuar një sezon turistik të suksesshëm, duke krijuar standardet e shërbimit dhe sigurim të këtyre standardeve më të larta në shërbime, siguri, pastërti dhe infrastrukturë përgjatë zonave turistike.

Përsa i përket përbërjes dhe hierarkisë, janë;

- Kryesimi nga Task-Forca e cila drejtohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit;
- Anëtarësia ku përfshin përfaqësues të nivelit të lartë (zëvendësministra ose titullarë) nga dikastere si Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë, si dhe drejtues të agjencive kombëtare (AKEP, FSHZH, etj.);
- Përfshirja e pushtetit vendor ku janë Kryetarët e bashkive të zonave bregdetare dhe turistike pjesë integrale e koordinimit.

Nërsa, fushat kryesore të monitorimit përfshijnë;

- Menaxhimi i mbetjeve urbane, pastrimi i plazheve dhe monitorimi i cilësisë së ujërave larës;
- Masat për rendin publik, sigurinë në plazhe (vrojtuesit), menaxhimin e trafikut dhe sinjalistikën rrugore;
- Garantimi i shërbimit urgjent mjekësor përmes qendrave shëndetësore verore dhe kontrollit të sigurisë ushqimore;
- Furnizimi i pandërprerë me ujë dhe energji elektrike, si dhe mbarëvajtja e transportit publik e detar.

Z. Orozi theksoi se mënyra e funksionimit është;

- Task-Forca mblidhet rregullisht për të analizuar situatën në terren dhe për të adresuar problematikat e shfaqura në kohë reale;
- Krijimi i grupeve të përbashkëta inspektimi për monitorimin e zbatimit të detyrave nga subjektet private dhe institucionet publike;
- Detyrimi për raportim të vazhdueshëm mbi progresin e masave të marra drejt Kryeministrit.

Gjithashtu z. Orozi përmendi objektivat specifike për sezonin 2026 si;

- Ofrimi i informacionit turistik përmes platformave digjitale;
- Kontrolli i rreptë i muzikës në zonat e banuara dhe plazhe;
- Monitorimi i çmimeve dhe transparencës së shërbimeve turistike.

Komente nuk ka.

**5. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”, propozuar nga Ministria e Mjedisit u prezantua nga Znj. Elvana Ramaj, Drejtor, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.**

Znj. Ramaj, në fjalën e saj theksoi se akti synon të rregullojë procesin e menaxhimit të mbetjeve në burim për të rritur riciklimin dhe mbrojtur mjedisin. Ajo përmendi qëllimin e aktit si;

- Përcaktimi i rregullave dhe standardeve teknike për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bashkiake;
- Reduktimi i mbetjeve që shkojnë në landfille përmes nxitjes së riciklimit dhe ripërdorimit;
- Plotësimi i kërkesave ligjore që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve sipas standardeve europiane.

Gjithashtu, kategoritë e mbetjeve për grumbullim të diferencuar ndahen në disa rryma kryesore:

- Letër dhe karton;
- Metal;
- Plastikë;
- Xham;
- Mbetje bio (mbetje organike/ushqimore).

Ndërsa, bashkitë kanë rolin kryesor në zbatimin e këtij vendimi si;

- Sigurimi i kontejnerëve të veçantë për secilën rrymë mbetjesh dhe caktimi i pikave të grumbullimit;
- Organizimi i transportit të diferencuar që mbetjet e ndara të mos përzihen gjatë rrugës për në pikat e trajtimit;
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe bizneseve mbi rëndësinë dhe mënyrën e duhur të ndarjes së mbetjeve.

Znj. Ramaj përmendi detyrimet e gjeneruesve të mbetjeve (Qytetarët dhe Bizneset) si;

- Detyrimi për t'i hedhur mbetjet në kontejnerët përkatës sipas ngjyrave ose shenjave dalluese;
- Ndalohet rreptësisht përzierja e mbetjeve të rrezikshme me ato bashkiake apo hedhja e tyre jashtë vendeve të caktuara.

Ndërsa, monitorimi dhe raportimi bëhet nga bashkitë, të cilat duhet të raportojnë periodikisht pranë institucioneve qendrore (Ministrisë së Mjedisit) për sasinë e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar si dhe monitorimi i zbatimit të detyrimeve nga ana e bizneseve dhe operatorëve të shërbimit për të garantuar që procesi kryhet sipas standardeve.

Komente;

Z. Brahimi parashtrroi pyetjen në lidhje me ndarjen e përgjegjësive për bashkitë dhe ndarjen e kostove për realizimin e shërbimit për rrymat e mbetjeve.

**6. Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për ushtrimin e kompetencave të inspektoriatit të përgjithshëm, rregullat për përmbajtjen, administrimin e të dhënave të sistemit elektronik”-inspektimi”, mënyrën e raportimit, kërkimit të informacionit, inspektimit të dosjeve dhe dokumentave të nevojshme, si dhe mbikëqyrjen në terren të procedurave të inspektimit”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Znj. Drilona Baruti, Inspektorati Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.**

Znj. Baruti në fjalën e saj theksoi se akti prezanton një reformë për riorganizimin e inspektorateve në nivel vendor, duke synuar një kontroll më efikas të territorit dhe rritjen e llogaridhënies së strukturave vendore si dhe nevojat për ndryshim dhe sfidat aktuale si;

- Ekzistenca e shumë strukturave të vogla inspektuese që shpesh mbivendosen në kompetenca;
- Nevoja për të unifikuar procedurat e inspektimit në të gjitha bashkitë për të garantuar trajtim të barabartë të subjekteve;
- Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore dhe logjistike në strukturat aktuale.

Ajo ndaloi të objektivat e riorganizimit si;

- Krijimi i Inspektorateve Rajonale ku kallohet drejt një strukture më të konsoliduar në nivel rajoni për të mbuluar disa bashki bashkërisht;
- Specializimi i trupës inspektuese me fokus të trajnimit dhe çertifikimit të inspektorëve për të rritur profesionalizmin;
- Përdorimi i sistemeve online për planifikimin dhe raportimin e inspektimeve për të rritur transparencën.

Ndërsa, fushat kryesore të inspeksionit vendor synojnë të mbulojë me prioritet:

- Mbrojtjen e territorit dhe ndërtimet dhe kontrolli i zbatimit të lejeve të ndërtimit dhe parandalimi i ndërtimeve pa leje;

- Mjedisi dhe menaxhimi i mbetjeve: Mbikëqyrja e subjekteve për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e burimeve natyrore lokale.;
- Hapësira publike dhe tregtia: Monitorimi i përdorimit të hapësirave publike dhe kushteve të tregtimit në tregjet vendore.

Znj. Ramaj u ndal te struktura dhe hierarkia e re;

- Koordinimi qendror me ndërveprim më të ngushtë me inspektoratet shtetërore për të shmangur kontrollet e dyfishta te i njëjti subjekt;
- Llogaridhënia dhe vendosja e mekanizmave të qartë raportimi mbi numrin e inspektimeve, gjobave të vendosura dhe masave korigjuese të marra.

Përfitimet e pritshme të aktit janë;

- Për qytetarët është mbrojtje më e mirë e interesit publik dhe mjedisit jetësor;
- Për bizneset është pakësimi i barrës administrative përmes inspektimeve të bazuara në risk dhe shmangies së abuzimeve;
- Ndërsa, për shtetin është kursim i burimeve dhe rritje e autoritetit të ligjit në territor.

Komente nuk ka.

**7. Projektudhëzimi “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave dhe vlerat mesatare të shitblerjes së banesave në treg, për vitin 2025, në përputhje me shkronjën ”dh”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018 ”Për strehimin social”, i ndryshuar, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit u prezantua nga Znj. Dardana Grabovaj, Drejtor, Drejtorja e Strehimit. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.**

Znj.Grabovaj theksoi se akti shërben si një dokument rregullator për zbatimin e politikave dhe procedurave specifike administrative për vitin e ardhshëm. Ky udhëzim synon të qartësojë hapat proceduralë dhe përgjegjësitë e institucioneve në zbatimin e buxhetit dhe planeve operacionale dhe siguron që të gjitha veprimet administrative të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe objektivat strategjikë të qeverisë për vitin 2025.

Znj.Grabovaj përmendi prioritetet operacionale për vitin 2025 si;

- Eficenca e burimeve me fokus te përdorimi racional i fondeve publike dhe burimeve njerëzore për të maksimizuar rezultatet;
- Vendosja e treguesve të qartë (KPIs) për të matur progresin e çdo nisme apo projekti të planifikuar;
- Rritja e nivelit të raportimit dhe llogaridhënies gjatë gjithë ciklit të zbatimit të detyrave.

Ndërsa, procedurat dhe afatet janë;

- Kalendari i veprimeve ku përfshihet përcaktimi i afateve strikte për dorëzimin e planeve të punës dhe raporteve periodike nga dikasteret përkatëse;

- Standardizimi me përdorim të formateve të unifikuara për çdo kërkesë apo procedurë administrative për të shmangur vonesat burokratike. Koordinimi ndërinstitucional konsiston në; nevojën për një ndërveprim të shpejtë dhe efektiv mes ministrive dhe agjencive zbatuese dhe zgjidhjen e ngërçeve me mekanizmat për adresimin e problemeve që mund të lindin gjatë zbatimit të udhëzimit në terren.

Znj. Grabovaj theksoi pritshmëritë dhe rezultatet e aktit si ;

- Përmirësimi i shërbimeve me synimin përfundimtar mbetet dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe subjekteve përmes një administrate më të organizuar;
- Qëndrueshmëria: dhe sigurimi që politikat e ndërmarra në vitin 2025 të kenë një impakt afatgjatë në zhvillimin e vendit.

Komente nuk ka.

**8. Projektvendimi “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës, mënyrës së transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin dhe të formatit tip të kontratës”, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u prezantua nga Z. Vasjar Shërmadhi, Drejtor, Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit.**

Z. Shërmadhi theksoi se ky projektvendim vjen si pasojë e ndryshimeve të vitit 2024 në ligjin “Për peshkimin”, duke zëvendësuar kuadrin e vjetër (VKM nr. 347/2019) që nuk reflektonte dinamikën e reja ligjore. Synohet përcaktimi i qartë i kriterëve, procedurave dhe miratimi i një kontrate tip për transferimin e asetëve dhe thjeshtimi i procedurave për të siguruar një zbatim të unifikuar dhe efikas drejt palëve përfituese. Akti bën një ndarje të qartë mes dy llojeve të infrastrukturës si:

- Infrastruktura e peshkimit përfshin portet, qendrat e peshkimit, vendzbatimet dhe asetet fizike përkatëse;
- Infrastruktura e lidhur me peshkimin përfshin markatat, tregjet e shumicës, linjat teknologjike dhe objektet e tjera mbështetëse.

Ndërsa, institucionet përgjegjëse dhe procedurat e transferimit janë;

- Drejtorja e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është organi përgjegjës për menaxhimin e drejtpërdrejtë ose ndjekjen e procedurave të transferimit.;
- Mënyra e Diferencuar e Transferimit është;
  - Infrastruktura e peshkimit transferohet te organizatat e peshkimit të njohura me ligj.;
  - Infrastruktura e lidhur me peshkimin ofrohet fillimisht njësisive të vetëqeverisjes vendore (bashkive). Nëse ato nuk shfaqin interes, transferohet te subjektet private përmes konkurrimit publik.

Marrëdhënia me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashkitë) është;

- Institucioni përgjegjës i drejtohet bashkisë përkatëse me propozim zyrtar që përmban kriteret e transferimit;
- Përgjegjësitë e Bashkisë vijon me marrjen e menaxhimit, njësia vendore merr përsipër;
  - Kostot e përdorimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës;
  - Pagesën e taksave të aplikueshme sipas legjislacionit në fuqi;
  - Garantimin e mirëmbajtjes së rregullt të këtyre aseteve.

Ndërsa, përfitimet e pritshme janë;

- Transparencë dhe Konkurrencë si dhe rritja e integritetit në proceset e transferimit të privatis;
- Investime dhe krijimi i kushteve më të favorshme për investime afatgjata dhe mirëmbajtje të specializuar;
- Monitorimi dhe vendosja e mekanizmave të saktë për kontrollin e zbatimit të kontratave midis shtetit dhe përfituesve.

Komente nuk ka.

**9. Projektvendimi “Për miratimin e rregullores tip “Për administrimin e banesave dhe ndërtesave””, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor u prezantua nga Znj. Griselda Elezi, Specialiste, Sektori Ligjor, AMVV.**

Znj. Elezi theksoi se akti përcakton rregullat e bashkëjetesës, organizimin e bashkëpronarëve dhe standardet e mirëmbajtjes së pronës së përbashkët ku Organizimi dhe vendimmarrja bëhet nga;

- Asambleja e Bashkëpronarëve që cilësohet si organi kryesor vendimmarrës në ndërtesë;
- Kryesia me Organin ekzekutiv dhe përfaqësues që zgjidhet nga asambleja. Dokumenti përcakton kompetencat e saj dhe procedurat për marrjen e vendimeve.
- Administrimi i Bashkëpronësisë trajtohet në format se si do të menaxhohet ndërtesa, standardet që duhen ndjekur për mirëmbajtjen dhe paketa e shërbimeve të administrimit;
- Zonat e përbashkëta ku rregullohen mirëmbajtja e tarracave, ashensorëve, parkimeve dhe hapësirave të tjera të përbashkëta;
- Për dëmet përcaktohen procedurat për verifikimin, vlerësimin dhe caktimin e përgjegjësisë kur shkaktohen dëme në pronën e përbashkët.

Financat dhe buxheti për mirëmbajtjen e ndërtesave përbëhet nga Buxheti i bashkëpronësisë ku shpjegohet mënyra e krijimit të buxhetit dhe detyrimet financiare që ka çdo bashkëpronar, si dhe fondit rezervë që rregullon krijimin dhe përdorimin e një fondi të veçantë për raste emergjencash ose për investime të nevojshme në ndërtesë.

Përsa i përket etikës dhe mirëjetesës konsistojnë në rregullat e etikës të cilat vendosin norma mbi bashkëjetesën në komunitet, përdorimin e ambienteve dhe mirësjelljen mes banorëve dhe të transparenca ku përfshihen dispozitat për të garantuar që administrimi të jetë transparent dhe i llogaridhënës ndaj bashkëpronarëve. Rregullorja është e ndarë në 10 krerë që mbulojnë të gjithë ciklin e menaxhimit, nga dispozitat e përgjithshme ligjore deri te procedurat specifike të mirëmbajtjes dhe sanksioneve.

Komente nuk ka.

#### 10. Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje të zhvilluar me datën 14 maj 2026

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Hantin Bonati	Zv/ministër	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
3	Elda Xhumari	Zv/ministër	Ministria e Mjedisit
4	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
5	Fran Brahim	Drejtor	Ministria e Financave
6	Ervis Moçka	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Vlorë

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për aktin e diskutuar në mbledhjen e Këshillit Konsultativ datë 14 maj 2026

Bashkëlidhur gjeni linkun e projektakteve që u diskutuan

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshilli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/14-maj/>

**Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ** *E-mail:* [keshilli.konsultativ@amvv.gov.al](mailto:keshilli.konsultativ@amvv.gov.al) *Adresa:* **Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.**